



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 400/2018

Datë: 7 shtator 2018

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 të Rregullores Nr.03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës së datës 7 shtator 2018-KPK/Nr.395/2018, shpall:

SHPALLJE E BRENDSHME

- I. Për plotësim me tri (3) pozita për prokurorë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.
- II. Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë këto kriterë:
 1. T'i plotësojë kushtet për të punuar si prokuror në Departamentin për Krime të Rënda, si dhe të ketë vlerësim pozitiv të performancës;
 2. Të kenë mandat të përhershëm;
 3. Të mos kenë të shqiptuar masë disiplinore, përveç qortimit.
 4. Pjesëmarrja në trajnime në fushën specifike që ndërlidhet me procedurën penale, mjetet juridike, praktikat juridike të gjykatave vendore dhe ndërkombëtare do të merret parasysh.
- III. Kandidati që parashtron kërkesën duhet të dorëzojë edhe dokumentet si në vijim:
 1. Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre vitet e fundit;
 2. Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;
 3. Dokumente apo të dhëna të tjera relevante ose objektivist të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.

- IV. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë.
- V. Afati për dorëzimin e kërkesës është nga data 17 shtator 2018 deri më datë 01 tetor 2018.
- VI. Kërkesa duhet të dorëzohet te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e parë (1) të ish ndërtesës së EULEX-it, rruga Luan Haradinaj - Prishtinë, zyra numër 18, të mbyllura në zarf, ose me postë.